Në bazë të nenit 10 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 dhe nenit 78 të Statutit të Komunës së Rahovecit, nenit 13 të Ligjit mbi shërbimin civil nr. 03/L-149 dhe Rregullores 02/2010, kërkesës së drejtorit të Drejtorisë komunale për bujqësi dhe zhvillim rural nr. 368/359.2010 të dt. 09.02.2011 të aprovuar nga kryetari i Komunës së Rahovecit, udhëheqësi i personelit publikon këtë:

SH P A L L J E

Për plotësimin e një vendi të punës:

1. Roje pylli (një)

Koeficienti i pagës 4.5

Detyrat / përgjegjësitë kryesore:

- Të ruajë nga vjedhja, shkatërrimi, dëmtimi i trungjeve të pa prera dhe të prera, si dhe pjesëve të trungjeve-drunjve në pyje e kulturat pyjore, shpyllëzimi etj.

- Të informojë për uzurpimet e pyjeve, tokave pyjore dhe objekteve përcjellëse

- Të parandalojë gjuetinë ilegale

- Të zbatojë planin e masave të përcaktuara në mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, mirëmbajtjen e pikave vrojtuese, vendosjen e shenjave paralajmëruese dhe ndalesave

- Të bëjë fletëparaqitje për veprimet ilegale të individëve në rast të prerjes dhe cenimit të pyjeve

- Të kryejë punët tjera sipas përshkrimit të vendit të punës

KUSHTET:

Të ketë të kryer së paku shkollën fillore

Të ketë shkathtësi punuese

Të njohë punët dhe detyrat e rojës së pyjeve

Të jetë i aftë psiko-fizikisht

Të mos jetë i privuar nga e drejta për posedim dhe bartjen e armës zyrtare

KUVENDI I KOMUNËS RAHOVEC

Të plotësojë klushtet tjera të parashikuara për pozitën e rojes së pyjeve

Kandidatët që i plotësojnë kushtet e mësipërme do të ftohen për intervistë

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente:

CV-në dhe dëshmitë përkatëse

Fletë aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e pranimit të KK në Rahovc

Kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen intervistës

Afati për aplikim tetë (8) ditë nga dita e shpalljes në faqen zyrtare të Komunës dhe në tebelën e shpalljeve.

Shefi i personelit

Ymret Reshiti